



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 74

Prishtinë, më 21.5.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala c-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Etem Arifi.

Mungoi : Daut Haradinaj dhe Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga KDI dhe Presidenca.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 16.5.2012,
3. Çështjet aktuale,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.5.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16.5.2012.

3. Projektligji për Ndërtimin

Kryetari Nait Hasani përshëndeti dhe njoftoi se duhet të bëhet riradhitja e amendamenteve për shkak të sqarimeve konkrete, ndaj u shtua Amendamenti 22 për shtojcën e ligjit dhe shtesa tek

neni 38 : Kodi i ndërtimit duhet të hartohet brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Të ndryshme

Në vazhdim u konstatuan përgjegjësitë sa i përket projektligjeve që gjenden në shqyrtim të komisionit , ndaj u vendos lidhur me takimet që duhet të mbahen rreth projektligjit për bujqësinë organike, bujqësinë dhe zhvillimin rural, për iniciativën “Të pastrojmë Kosovën” për datën 24 maj 2012 ku duhet ftuar edhe përfaqësuesin e MMPH si dhe për GP rreth monitorimit të ligjeve (ajrin, zhurmën dhe natyrën).

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani